

**D E K R E T**  
**Nr.1568, datë 2.8.1996**

**PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7941, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

**D E K R E T O J:**

Neni 1

Krijohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë si organ i përhershëm, i cili organizon, drejton dhe kontrollon zhvillimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore elektorale të shtetit shqiptar.

Neni 2

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari dhe 14 anëtarë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Ministrave dhe të partive politike.

Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre për një periudhë 7-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Neni 3

Paragrafi i 2 i nenit 35 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, ndryshohet si vijon:

"Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre."

Neni 4

Në fjalinë e parë të nenit 46 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, hiqen fjalët: "... në Komisionin Qendror apo...".

Neni 5

Paragrafet 2 dhe 3 të nenit 29 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", ndryshohen si vijon:

"Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues pranë tij, që nga data e fillimit të fushatës së zgjedhjeve e deri në përfundim të tyre."

Neni 6

Në paragrafin 1 të nenit 36 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", hiqen fjalët "... në Komisionin Qendror apo...".

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET  
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
**Sali Berisha**